

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Nga Nikola Kedhi - Kontrata e Dinjitetit: Ose e shpëtojmë bashkë Shqipërinë, ose e humbim përgjithmonë
ADRESA	https://www.syri.net/op-ed/919886/kontrata-e-dinjitetit-ose-e-shpetojme-bashke-shqiperin-e-ose-e-humbim-pergjithmone/
BURIMI	syri.net
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	29 shtator 2026, 09:37:11 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	29 shtator 2026, 09:32:59 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	987db1a10027c1a20e10d34df30d45a9bb686e1cd24019a2137461b8a37d8940
TEKSTI	73b06d9afe6848cbc1c521d4921fa5e38f60c5c969d399c072d859615403a6d6
PAMJA	b10c29ba2952f49029a41547b7cf2191ae2836ddf38a7e766871eedec2b179ec

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	5fac4b3f942e4e7da4e9f76f4560b9ba6288cd463cba706606e1f50bb304fa2c
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	f52a1d397c683d722882998d1b0c047f87c1de2f74016889fd5b4e655403fa0f
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/5fac4b3f942e4e7da4e9f76f4560b9ba6288cd463cba706606e1f50bb304fa2c>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px




NIKOLA KEDHI

Kontrata e Dinjitetit: Ose e shpëtojmë bashkë Shqipërinë, ose e humbim përgjithmonë



GENC POLLO

Dy Edi Ramat në Nju Jork dhe raporti i sikletshëm me të tashmen e të shkuarën



Kontrata e Dinjitetit: Ose e shpëtojmë bashkë Shqipërinë, ose e humbim përgjithmonë



Nga Nikola Kedhi - 11:32, 29/09/2026

Shqiptarët kanë zbritur prej gati katër muajsh në shesh. Kërkojnë të jetojnë në vendin e tyre me dinjitet, në normalitet, si çdo popull tjetër i këtij kontinenti. Vetëm kaq. Asgjë jashtë normales, apo të jashtëzakonshme. Pikërisht kjo kërkesë e thjeshtë është kthyer sot në kërkesën më thelbësore në Shqipëri, nga të gjitha grupimet shoqërore.

Shtyllat e Republikës kanë rënë. Modeli ekonomik favorizon një pakicë oligarkike dhe mbahet në këmbë nga paratë e drogës që pastrohen në ndërtim e turizëm. Siguria kombëtare ka rënë në dorë të kimit duke cenuar sigurinë tonë, dhe atë të partnerëve tanë. Korrupsioni është ngjitur në nivele rekord, dhe sipas Transparency International, vendi ynë ra me 11 vende në vetëm 1 vit. Atdheu po shitet copë-copë, ndërsa shqiptarët po dëbohen dhe po zëvendësohen. Krimi nuk po sfidon pushtetin, por është tashmë pushteti. Asnjëherë në këto 36 vite nuk kemi qenë të rrezikuar në këto përmasa. Në pak vite nuk kemi për ta njohur më vendin tonë. Ndaj, si shumë herë përgjatë historisë sonë, në momentet e rrezikut më të lartë, na duhet të ngrihemi në lartësinë që kërkon Shqipëria.

Shqipëria u përket shqiptarëve. Liria, atdheu, dinjiteti dhe prona nuk janë të negociueshme. Kjo është ajo që na mban të gjithëve bashkë, edhe kur nuk biem dakord për asgjë tjetër.

Natyrisht, protesta heroike në Bulevard nuk është pronë e askujt, as e jona, edhe pse ne e mbështesim plotësisht e pa kushte. Ne kemi bindjen absolute se suksesi i protestës është suksesi i Shqipërisë. Ajo nuk nisi nga një zyrë partie dhe nuk do të mbarojë me urdhër nga lart.

Protesta nisi nga llogaritjet që çdo familje shqiptare duhet të bëjë që të arrijë të mbyllë muajin me shumë vështirësi, nga mungesa e shërbimit minimal shëndetësor, nga arsimi i shkatërruar me qëllim, nga radhët në Rinas të të rinjve shqiptarë që detyrohen të kërkojnë fatin diku tjetër, nga kriminalizimi i ekonomisë e shoqërisë, nga rënia totale e shtetit dhe shkrirja e shtetit me partinë dhe me krimin, nga çmimet e larta të ushqimeve e apartamenteve e fuqia blerëse më e

më të lexuarat



Rama heshti për Kosovën në OKB, nuk iu kundërvu Vucicit dhe zgjodhi të flasë për Diellën



Pikturi do të lërë emër në histori, por si 'kreu i qelbësirave' dhe antishqiptar i përbetuar!



Dy Edi Ramat në Nju Jork dhe raporti i sikletshëm me të tashmen e të shkuarën



Kur populli e bojkoton shkrimtarin, para se shkrimtari të bojkotojë popullin



Friedrich Merz – Kancelar në gatishmëri



Kontrata e Dinjitetit: Ose e shpëtojmë bashkë Shqipërinë, ose e humbim përgjithmonë



Një shoqëri mashtruesish

u etne Europe, nga mungesa e meritokracisë në një sistem që shpeshin te fuqishmin, mikun e kryeministrit, të fortin e rrugës, dhe jo të zotin, të aftin, të riun që do të kontribuojë në vendin e vet.

Të gjithë këto arsye na bashkojnë. Patjetër që mes atyre që qëndrojnë çdo mbrëmje në shesh ka shumë njerëz që nuk u besojnë as partive, as neve. Besimi mes nesh, mes të gjithë grupimeve në shoqërinë shqiptare, është dëmtuar dhe do të kërkojë vite për t'u rikthyer. Por rikthimi i tij nis nga e vetmja gjë që na bashkon edhe kur nuk duam ta pranojmë, dhe ajo është Shqipëria.

Në këtë gjendje emergjence kombëtare ne nuk duhetë ndëshkojmë Shqipërinë për mosbesimin që kemi ndaj njëri tjetrit. Shqipëria nuk ka kohë të presë derisa ne të zgjidhim çdo dallim që kemi.

Ky pushtet nuk mbahet se është më i fortë se ne. Mbahet me lodhjen tonë, me dyshimin që kemi te njëri tjetri, me përçarjen që ai shkakton mes nesh. Ai fiton vërtet vetëm kur e bind secilin prej nesh se ndryshimi është i pamundur. Frika është e vetmja taksë që ky pushtet e mbledh me sukses. Detyra jonë është ta thyejmë këtë bindje. Shqipëria nuk është e dënuar të jetë vendi i varfërisë, i shpërpullimit, i padrejtësisë dhe i frikës.

Ne, për sa na takon, po e rindëtojmë forcën tonë politike nga poshtë lart, nga anëtarë të qendrës, duke pranuar edhe gabimet tona. Po ndëtojmë përgjegjësi të matshme, njerëz me emër për çdo detyrë, disiplinë shumë më të madhe. Që ky regjim të bjerë, gjithsecili duhet të jetë në formën e vet më të mirë, me armët më të mira që ka. Ne po bëjmë tonën që të jemi në lartësinë që shqiptarët kërkojnë.

Koha na ka dhënë të drejtë. Të gjithë denoncimet e opozitës sot janë të faktuara. Kërkesat tona në vite sot janë 5 kërkesat zyrtare dhe të protestuesve. Ne kemi denoncuar prej vitesh edhe ligjet që kërkohen sot të abrogohen nga qendrëstaret. I kemi çuar në Gjykatë kushtetuese dhe kemi bërë disa beteja kundër tyre dhe porositësve të këtyre ligjeve. Qëllimi ynë është i përbashkët.

Ky pushtet autokratik nuk bie nga fjalime dhe nuk bie nga një protestë e vetme. Bie kur takohen dy forca: trysnia nga jashtë dhe trysnia nga brenda. Sot, për herë të parë pas shumë vitesh, po ndodhin të dyja. Jashtë, mbulesa politike që e ka mbrojtur këtë qeveri ka rënë. Përgjimet që publikohen, retorika e ashpërsuar e partnerëve tanë, si dhe raportet ndërkombëtare janë shenjë e qartë e kësaj. Brenda, njerëzit kanë vrarë frikën, dhe kur një popull bën këtë hap, pushteti e humb burimin kryesor të energjisë së vet. Rreziku i vetëm real nuk është forca e tyre. Është lodhja dhe përçarja jonë. Ata nuk kanë nevojë të na mundin. Kanë nevojë vetëm të presin derisa ne të mundemi me njëri-tjetrin. Ne sot jemi në momentin më të mirë për të rrëzuar të gjithë bashkë këtë regjim të goditur për vdekje. Është thelbësore që të gjithë të dalim në shesh në numra masivë e me një kërkesë të qartë e të drejtuar te individ i vetëm përgjegjës për këtë situatë,

Për këtë arsye, Shqipëria ka nevojë sot për një Kontratë të Dinjitetit, një besëlidhje reale, të sigurtë mes njerëzve të ndershëm të këtij vendi, një marrëveshje morale që nisemi ta bëjmë së pari me njëri-tjetrin dhe vetëm pastaj me shtetin. Një zotim se Shqipëria nuk do të jetë më pronë e pushtetit, plaçkë e oligarkëve, tokë pa zot dhe vend prej nga ikin të rinjtë dhe familjet.

Kjo është emergjencia dhe detyra e çdo patrioti sot. Gjithçka tjetër vjen pas saj. Kërkesa jonë e përbashkët është e qartë dhe e kufizuar: largimi i këtij pushteti dhe një qeveri teknike, e paanshme, me një mandat të shkurtër dhe të matshëm, që kthen institucionet te ligji, liron administratën nga frika, çliron median dhe organizon zgjedhje vërtet të lira e të ndershme. Partia Demokratike nuk kërkon të drejtojë qeverinë teknike. Ne kërkojmë vetëm rregulla të qarta e të drejta loje për të garuar më pas si gjithë të tjerët.

Pas rënies së Ramës mbaron dhe puna e frontit të përbashkët dhe nis puna e demokracisë, sado e brishtë të jetë ajo. Atëherë do të kemi kohë të tepërt për të diskutuar dallimet tona, të cilat janë reale. Do të dalim përpara shqiptarëve me programe të ndryshme, me ide të ndryshme, me gara të ashpra, dhe le të zgjedhin ata. Ky është kuptimi i lirisë. Dallimet të zgjidhen me votë e jo me dhunën e pushtetit.

Pas kësaj vjen puna e vërtetë, ajo e rindërtimit të Republikës mbi disa shtylla të drejta, pavarësisht se kush qeveris. Republika e Dinjitetit është një Republikë ku rregullat nuk i lejojnë askujt që qeveris të bëjë çfarë të dojë. Ku puna shpërblehet më shumë se lidhjet me pushtetin. Ku merita të hapë dyer, jo lidhjet me pushtetin. Ku prona të mbrohet nga shteti, jo të grabitet prej tij. Ku familja të jetë themel i shoqërisë dhe jo llogari e fundit e buxhetit. Ku sipërmarrja të çlirohet nga klientelizmi dhe të konkurrojnë me cilësi, jo me afërsi. Ku shteti të mos jetë zot mbi qytetarin, por garant i rregullave të ndershme. Ku ekonomia të ndërtohet mbi prodhimin, punën, inovacionin dhe konkurrencën, jo mbi para që vijnë nga hijet dhe ikin po aq shpejt. Dhe mbi të gjitha, ku asnjë i ri të mos detyrohet të zgjedhë



Gratë e reja të inatosura të së majtës po shkatërrojnë të ardhmen e tyre



Nga copëtimi të kriminalizmi/ Një shekull narrativë ndaj shqiptarëve

mes dinjitetit dhe largimit.

Kjo do të thotë një prind që e dërgon fëmijën në spitalin publik pa telefonuar askënd. Një zyrë hipotekash ku dosja jote ecën me radhë dhe jo me njohje. Një i ri i cili zgjedh të blejë shtëpi këtu dhe jo biletë avioni. Një sipërmarrës që merr tenderin sepse ka ofertën më të mirë, jo mikun më të fortë. Nuk është utopi. Është normaliteti i çdo vendi evropian.

Ne e kemi dorën të shtrirë për këdo, sado skeptik të jetë me ne. Jemi gati të ulemi me këdo që e do këtë vend, të bisedojmë për çdo formë bashkëpunimi, të heqim dorë nga çdo lloj përparësie që na takon apo mendojmë se na takon, me një kusht të vetëm: që në fund të kësaj beteje të mos ketë fitues partish, por një vend të ripërtërirë që fiton.

Në fund, ose e shpëtojmë bashkë Shqipërinë, ose e humbim përgjithmonë. Nuk ka rrugë të tretë dhe nuk ka shpëtim të veçantë për askënd.

Ne besojmë te Republika e Dinjitetit. Le ta ndërtojmë së bashku.

© SYRI.net

Lexo edhe

» Një shoqëri mashtruesish

» Çfarë po 'gatuajnë' protestat kosovare, kombëtarizim apo rimëkëmbje ideologjike?

» Dy Edi Ramat në Nju Jork dhe raporti i sikletshëm me të tashmen e të shkuarën

Komentet

Shto koment

Emri

Shkruani komentin tuaj

Posto

TË NGJASHME



Piktori do të lërë emër në histori, por si 'kreu i qelbësirave' dhe antishqiptar i përbetuar!



Gratë e reja të inatosura të së majtës po shkatërrojnë të ardhmen e tyre



'Nuk e dija, nuk mjafton më'



Friedrich Merz – Kancelar në gatishmëri



Kur populli e bojkoton shkrimtarin, para se shkrimtari të bojkotojë popullin



Rama heshti për Kosovën në OKB, nuk iu kundërvu Vuçiçit dhe zgjodhi të flasë për Diellën



Xi dhe Trump morën pikërisht atë që donin nga vizita shtetërore

LAJME POLITIKË KRONIKË EKONOMI KOSOVA BOTË KULTURË SHKENCË SPORT JETË/STIL TRASHËGIMI MIEDIS ARKIVA



SYRI.net është agjencia më e madhe e lajmeve në Shqipëri, që brenda një kohe të shkurtër është kthyer në lider të informacionit. Në SYRI.net do të gjeni opinionistë më me emër në vendin tonë, investigime dhe lajme që nuk do ti gjeni diku tjetër. Lajmet në SYRI.net janë prodhim i SYRI.net dhe nuk lejohet marrja e tyre pa një komunikim të mëparshëm me redaksinë. Ju ftojme të klikoni dhe të na shkruani sa herë që ju mendoni se duhet. Staf i SYRI.net

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.